

FATOS KONGOLI
KAPITULLI I AMERIKËS

KUJTIME

BOTIMET TOENA

FATOS KONGOLI

KAPITULLI I AMERIKËS

**- Në vazhdim të një kronike
të papërfunduar për vetveten -**

kujtime

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2020

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Petrina Ago

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-87-9

© Autori dhe Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

Ia kushtoj mikut tim të shtrenjtë JULIEN ROCHE

Autori

PJESA E PARË

1.

Ideja për të hedhur këto shënime më ka lindur në rrethana disi të veçanta, kur as e mendoja e as dëshiroja të shkruaja përsëri. Nga fillimi i vitit 2018, në muajin janar dhe, më pas, në shkurt, iu nënshtrova dy operacioneve radhazi për shkak të një sëmundjeje të rëndë. Nuk dua të zgjatem këtu me hollësitat e sëmundjes, por mbaj mend turbull diçka: një nga miqtë e mi, gjatë një vizite që më bëri në spital, i nxitur ndoshta nga çfarë ishte thënë ato ditë për gjendjen time, më sugjeroi që sapo ta merrja veten, të shkruaja përjetimet e mia. Është vërtet e çuditshme përse ky sugjerim më kujtohet mirë dhe nuk e mbaj mend fare se kush ma bëri.

Lodra të vetëdijes dhe të pavetëdijes, them tani, në kufijtë ku këto takohen, ndërfiten te njëra-tjetra. Kur nuk e kupton se ku je, në cilën botë, për të mos thënë kur

nuk e kupton mirëfilli nëse je gjallë, apo i vdekur. Ndryshe nuk mund ta shpjegoj përse, në ekranin e trurit, si refleksi i asaj bisede, zunë të më shfaqeshin skena të një nate të errët kur uragani “Sandy”, ndër më shkatërrimtarët që ka goditur ndonjëherë gadishullin “Rockaways” në Queens të Nju-Jorkut, nga fundi i tetorit të vitit 2012, u vërsul me tërbim, duke mbjellë vdekje, disa dhjetëra të vrarë nën rrënojat e shtëpive dhe dëme të tjera materiale të pallogaritshme.

Në gjendjen kur vetëdija dhe pavetëdija kurdisin ç’të duan, dola nga nata e errët, u vendosa tek e nesërmja, dhe e nesërmja m’u shfaq me një anije të rrëmbyer nga furia e përbindshme e erës dhe ujërave, e flakur si një cingël nga bregu i Oqeanit Atlantik, në mesin e një rruge automobilistike, që përshkonte një qendër të vogël të banuar. Ideja e këtyre shënimeve pluskoi brenda meje kur përpiqesha të zgjidhja një enigmë që po më mundonte: kur dhe kush më kishte sugjeruar të shkruaja përjetimet e mia të asaj nate të frikshme të uraganit “Sandy”?

Sigurisht, thashë me vete në një çast kthjellimi të atyre ditëve, nëse unë vërtet do të bëhem për të shkruar, si më sugjerojnë miqtë e mi, më shumë një dëshirë e tyre, kjo

për të më dhënë zemër, sesa një mundësi reale, pra nëse do të ndodhte që unë të ulesha sërish pranë tryezës së punës, do të zgjidhja të përmbushja pa ngurrimin më të vogël sugjerimin lidhur me përjetimet e mia për uraganin “Sandy”.

Unë nuk e besoja se një çast i tillë do të vinte. Për më tepër, siç e vura në dukje, nuk kisha më asnjë dëshirë të shkruaja. Mirëpo të shkruarit doli se ishte për mua një sëmundje shumë më e fortë, sesa ajo nga e cila sapo kisha shpëtuar mrekullisht. Një sëmundje nga e cila nuk gjen dot shërim. Dhe mbërriti dita që iu drejtova tryezës së punës. Për të qenë i saktë, prej kohësh, qysh përpara se t’u nënshtroheshja operacioneve, unë nuk mbyllesha më në mjedisin tim të parapëlqyer, njëfarë studioje, ku gjendet edhe tryeza ime e punës. Prej kohësh punoja në prani të Lilit, bashkëshortes sime, në dhomën, ku rrinim zakonisht, ku prisnim ndonjë vizitor, njëherazi e përdornim edhe si dhomë ngrënieje. Mjeti i punës: një laptop “Samsung”.

Kur më në fund u ktheva në shtëpi pas nja shtatë-tetë muajsh mungese, në fillim në spital, pastaj në vilën e mikut tim Julien Roche (Zhylien Rosh), m’u desh njëfarë

kohe të mësohesha me gjithçka, edhe me laptopin, t'i rifitoja shprehite e dikurshme. Sado ngathtësish, këto i rifitova. Por, ajo që ia vlen të nënvizoj me këtë rast, është se në laptop, pashmangshëm gjeta një roman të filluar, të mbetur në mes të rrugës për shkak të sëmundjes. E kam fjalën për romanin me titull “Gënjeshtarë të vegjël”. Nuk ia kisha zënë me gojë askujt. Edhe pas kthimit në shtëpi nuk ia zura me gojë askujt. Ai po më dukej si një qenie e braktisur nga unë vetë. U ndjeva borxhli ndaj tij. Dhe e vendosa, nuk do të merresha me asgjë tjetër pa u shlyer me këtë qenie të braktisur. Kështu ndodhi që për disa muaj u mora me romanin “Gënjeshtarë të vegjël”, derisa mbërriti çasti kur teksti u mbyll me fjalën “FUND”. (6 mars, 2019)

Atëherë mbeta bosh, u përpiva nga vuajtja e të qenët bosh. Në atë zbrazëti, brenda meje u zgjua vetvetiu ideja e kllapisë sime në spital. Tashmë, jo thjesht për të hedhur përjetimet nga uragani “Sandy”, por për diçka që shkante përtej tyre. “Kapitulli i Amerikës”, do ta quaja.

2.

Për herë të parë kam shkuar në SHBA, në New York (tash e tutje do ta shkruaj Nju-Jork), te fëmijët e mi, në korrik të vitit 2002. Një vit më parë atje kishte qenë Lili, në periudhën e verës. Fill pas kthimit të saj prej andej, ndodhi tragjedia e 11 shtatorit.

Në atë kohë, unë kisha ende një përfytyrim naiv - nuk gjej cilësim më të përshtatshëm - për Amerikën, dua të them SHBA-në. Kisha gjithashtu një përfytyrim po aq naiv për Europën. (E duam Shqipërinë si gjithë Europa!) SHBA-ja dhe Europa në sytë e mi përfaqësonin një botë të vetme, Perëndimin. Por, nëse në këtë përfytyrim nuk kishte asgjë të gabuar, bindja e rrënjosur brenda meje, gjatë dekadave të diktaturës, se kjo ishte një botë ideale, ku mbretëronin mirëqenia, harmonia etj. etj., ishte pa dyshim e gabuar. Një naivitet, me të cilin sot do të zbaviteshin edhe adoleshentët.

Vitrina e Perëndimit për ne shqiptarët, ndër qeniet më të shtypura e më të izoluara të rruzullit, ishin veçanërisht kanalet televizive italiane. Televizorët ende nuk kishin hyrë në përdorimin e përditshëm dhe familjet, që kishin një aparat të tillë, numëroheshin me gishtat e dorës. Më të rrallë ndodhte që dikujt t'i vinte ndonjë televizor nga jashtë. Më kujtohet se si një mikut tim të fëmijërisë i mbërriti një televizor nga një i afërm në Amerikë, dhe shtëpia e tij u kthye me plot kuptimin e fjalës në kinema. Ai banonte në një shtëpi përdhese me oborr. Mbrëmjeve e nxirrte televizorin jashtë dhe oborri mbushej plot e përplot me shokë e miq, që rrinin atje deri në orët e vona, duke ndjekur programet. Përgjithësisht kjo ndodhte në të gjitha ato familje që kishin një televizor, pavarësisht se ku jetonin, në një shtëpi me oborr apo në ndonjë apartament.

Deri atëherë valët televizive të kanaleve italiane, transmetoheshin nga antenat e Dajtit posaçërisht për një rreth tepër të ngushtë në sferat më të larta të nomenklaturës. Duket, për shkak të ndonjë “dekonspirimi” nga njerëzit e tyre, ato zunë të kapeshin edhe “poshtë”, dhe regjimi për çudi nuk e vlerësoi menjëherë rrezikun. Me

shtimin e shpejtë të numrit të televizorëve në përdorimin masiv, si nevojë e propagandës së ditës, shkujdesja e regjimit nuk vazhdoi gjatë, mamutët e diktaturës reagues, transmetimet nga Dajti u ndërpre. Kjo është një temë jashtë synimit të këtyre shënimeve, por, lidhur me këtë, nuk mund të rri pa kujtuar një episod qesharak. S’dihet sesi edhe pasi u ndërpre sinjalet e Dajtit, për njëfarë kohe këto vazhduan të lëshoheshin mbrëmjeve, në orën njëzet, me sa mbaj mend, dhe ne mund të shihnim të famshmen “Telegiornale” në Rai 1, domethënë emisionin e lajmeve. Sapo mbaronin lajmet, ndërpritej edhe sinjali. Sinjali ndërpritej menjëherë edhe në një rast tjetër... kur në ekran shfaqej figura e Papës! Një nga idiotësitë më të papërfytyrueshme të censurës së regjimit. Derisa edhe transmetimi i emisionit të lajmeve u vlerësua i rrezikshëm dhe u ndërpre.

Thashë se vitrina e Perëndimit për ne shqiptarët kanë qenë sidomos kanalet televizive italiane. Ç’është e vërteta, një vitrinë sugjestionuese, marramendëse, plot drita etj. etj. Me këtë shpjegohet që ballafaqimet e para të shqiptarëve me Perëndimin, falë përfytyrimeve plot iluzione të gabuara,

të krijuara ndër vite për një botë që ata e njihnin vetëm nga ekрани i televizorit, kanë qenë dramatike, mjafton të kujtojmë eksodet e fillimit të viteve '90, të shekullit të kaluar drejt Italisë. Pa dyshim, Perëndimi ishte dhe është një botë me vite dritë larg botës mjerane ku jetonim e jetojmë ne, kjo është një ndër arsyet e shumta, që edhe sot e kësaj dite prirja për të braktisur vendin, për të marrë arratinë drejt Perëndimit, mbetet po ajo e viteve '90, por me një ndryshim. Shqiptarët nuk janë më naivët e fillimit të viteve '90, nuk besojnë asnjë lloj vitrine. Thënë ndryshe, nuk kanë më përfytyrime të ëndërrta. Si nuk kam as unë.

Së fundi, për të ilustruar naivitetin tim të asaj kohe, po sjell një shembull kuptimplotë. Në një nga daljet e mia të para nëpër Europë, jam skandalizuar kur në një mbledhje dëgjova dikë, një europiano-perëndimor, të mbante një diskutim fund e krye antiamerikan. Nuk desha t'u besoja veshëve. Kjo nuk përputhej me përfytyrimet e mia të asaj kohe për Perëndimin. Çka sot, më së paku, do të tingëllonte një idiotësi! Por le të kthehem më mirë tek ai muaj i nxehtë korriku i vitit 2002, kur vajta për herë të parë në Nju-Jork, te fëmijët e mi.

Atëherë ata jetonin bashkë, në një apartament të tipit “vagon”: dy dhoma komunikuese, njëra më e madhe (e vajzës), ku kishin instaluar një kondicioner, tjetra më e vogël (e djalit). Një derë e ndante prej tyre atë që po e quaj kuzhinë, e formuar nga një mjedis për të ndenjur, me një divan, dy kolltukë dhe një tryezë të ulët përballë televizorit. Përtej një paretë vinte soba me gaz, një lavapjatë, në mes një tryezë ngrënieje me disa karrige, pra një lloj “livingroom”-i.

Apartamenti, në katin e dytë të një godine tipike amerikane prej druri, me çati, me dy kate dhe dy hyrje, ndodhej në Queens, në rrugën “Regevood”. Pronare ishte një zonjë serbe. Nuk më kujtohen as fytyra, as emri i saj. Mbjaj mend se ishte nja pesëdhjetë apo pesëdhjetë e pesë vjeçe, ndodhej në Amerikë prej rreth njëzet vjetësh, por mezi lidhte dy fjalë në anglisht. Mbjaj mend, gjithashtu, se kishte ardhur për të bujtur tek ajo, për nja gjashtë muaj, nusja e të birit nga Beogradi, e cila e fliste anglishten mirë dhe punonte si shitëse në një dyqan të lagjes, ku tregtoheshin veshje.

Një buzëmbremje gruaja m'i mburri fëmijët, më tha se ishin të edukuar. Po rrinim te shkallët e jashtme të hyrjes, ajo,

vajza ime Elda dhe unë, në pritje të Danielit, sot bashkëshort i saj, atëherë vetëm i fejuari, me të cilin se ku do të shkonim. Megjithëse ende nuk isha në gjendje të lidhja as dy fjalë në anglisht, e kuptova ç'më tha. Dukej qartë, marrëdhënia e vajzës me pronaren e shtëpisë, e cila banonte në katin poshtë fëmijëve, ishte shumë miqësore dhe për arsye që mund të merren me mend më shkaktoi një lloj mrekkullimi. Më pas mësova se në fillim marrëdhënia nuk kishte qenë dhe aq miqësore me djalin, Dorianin. Ky rrinte natën vonë duke punuar në kompjuter, luante me video etj., shkurt shkaktonte zhurma, që për shkak të dyshemesë prej dërrase, dëgjoheshin poshtë. Një natë pronares i qe sosur durimi, shkon në bodrum dhe ia ndërpret dritat. Im bir, pa e zgjatur, lajmëron policinë, që nuk mungon të mbërrijë, dhe pronarja detyrohet t'ia lëshojë dritat sërish. Por ky kishte qenë vetëm një incident tashmë i kapërcyer.

Sidoqoftë, porosia e parë që më dhanë fëmijët me të futur këmbët në shtëpi ishte që për sa kohë të qëndroja atje, të mos bëja as zhurmën më të vogël. Për aq kohë sa qëndrova atje, rreth një muaj e gjysmë, iu përmbajta rreptësishtë kësaj porosie,

megjithëse një qejfmbetje e pata me serben. Ajo i paskej thënë vajzës se babai i tyre, domethënë unë, nuk i vinte nënës as te thoi i këmbës. Më mbeti qejfi, nuk e pata të qartë se në ç'kuptim, sipas serbes, unë nuk i vija gruas sime as te thoi i këmbës. Ndoshta ngaqë Lili është e qeshur, duket shumë më e re se unë, kur në të vërtetë kemi vetëm katër vjet e gjysmë diferencë.

Ajo ishte një lagje e qetë, vendi ku banonin fëmijët edhe më i qetë. Përballë shtëpisë, matanë rrugës, ndodhej një kishë, ku të dielave kishte gjallëri. Prapa shtëpisë, një shkollë, edhe kjo fetare. Dhe befasia më e madhe: kambana e kishës, e cila binte gjatë gjithë ditës në orët e plota, më kujtoi kumbimin e dikurshëm të Sahatit të Elbasanit, rrëzë të cilit ndodhej shtëpia e tim ati. E pabesueshme, e njëjta tingëllimë.

Nga njëra anë, rruga përpara shtëpisë të nxirrte pranë hapësirës së varrezave; në anën e kundërt, te një rrugë me shumë lëvizje, në dy krahët e së cilës vargëzoheshin ndërtesa të ulëta, një, ose dykatëshe, plot me dyqane. Një mjedis krejt i ndryshëm nga zemra e Nju-Jorkut, *Manhatani*. Sa herë udhëtoja me autobus dhe me tren për të shkuar gjëkund, në vajtje dhe në kthim më qëllonte jo rrallë të dëgjoja të flitej shqip.

Në atë qëndrim të parë në Nju-Jork, prej një muaji e gjysmë, gjatë dy javëve të para vizitova vende, ku më vonë, për vite me radhë, nuk e pata më mundësinë të shkoja prapë. Fëmijët dhe Danieli, i vetmi që kishte makinë dhe banonte diku rreth njëzet minuta larg nesh, për të më sajdisur sa të mundnin, si kishin sajdisur përpara meje Lilin, e rregulluan t'i merrnin lejet e pushimeve njëri pas tjetrit. Në fillim Elda me të fejuarin. Pastaj Dori, por ky mundi të më shoqëronte më pak. Punonte në dy shoqëri ajrore në aeroportin *JFK*, lodhej shumë dhe paguhej pak, ikte në mëngjes herët nga shtëpia dhe kthehej afër mesit të natës, udhëtimi vajtje-ardhje me autobus i merrte shumë kohë. Po në atë aeroport punonte edhe vajza me të fejuarin. Elda, falë italishtes, që e zotëronte jo keq, fillimisht kishte zënë vend te linja ajrore “Alitalia”, në sektorin *Check-in*. Tashmë, pasi kishte konkurruar me disa “rivalë” e “rivale”, qe ngritur në detyrë, shërbente në kullën e kontrollit të Terminalit 4. Danieli punonte në po atë terminal, si supervizor i sallonit të *VIP-ave*. Duke qenë në një detyrë të tillë, ai kishte marrëdhënie me një numër kantinash vere në Long Island, një krahinë plot diell,

me vreshta pa fund. Një ditë vajtëm atje të tre; Danieli, Elda dhe unë, dhe pata rastin të vizitoja disa kantina, ku shijuam verëra të mrekullueshme.

Shënoj këtu një hollësi që e kam vënë në dukje edhe më parë. Fëmijët e mi vajtën në Amerikë si fitues të së ashtuquajturës Lotari Amerikane, në fillim vajza, në vitin 1998, dy vjet më vonë, në vitin 2000, djali. Kështu deshi Providenca. Eldën sapo e kishin pushuar nga puna në Ministrinë e Shëndetësisë, ku kishte qenë zëdhënëse shtypi, doemos për shkaku tim, atëherë redaktor i rubrikës kulturore në gazetën “RD”. Me të mbërritur në Nju-Jork, ajo më tha në telefon se, për ironi, paskej udhëtuar për në Amerikë me të njëjtin avion, ku udhëtonte edhe zotëria, ministër i Shëndetësisë, urdhërues i largimit të saj nga puna... Ndërkaq, djali, student në vitin e dytë të degës “Veterinari” në Universitetin Bujqësor, qysh se e motra ishte larguar, rrinte tërë kohën me mendje të ngritur, që Fati t’i buzëqeshte edhe atij. Dhe Fati i buzëqeshi vërtet.

Unë nuk bëra as përpjekjen më të vogël për t’ua prishur mendjen, që të mos largoheshin, as vajzës, as djalit. Për

shkakun tim e ardhmja për ta do të ishte e zymtë në Shqipëri. Dhe shpesh pyes veten: “A do të marrë fund ndonjëherë fryma e qelbur e luftës së klasave, e trashëguar nga epoka e diktaturës dhe e zbatuar me po aq zell edhe sot e kësaj dite nga të gjithë krahët e politikës, sa herë vijnë në pushtet? Deri kur do të vazhdojë kjo mendësi rrënuese e kombit tonë, që nuk po arrin të ngrejë krye?”

Nuk e di, ndoshta do të marrë fund një ditë. Por unë jam pesimist, së paku nuk besoj se do të arrij ta shoh atë ditë. Jam i sigurt për një gjë: edhe nëse unë do të isha orvatur t’ua prishja mendjen, në fillim vajzës, pastaj djalit për të mos u larguar, do të kishte qenë frymë e harxhuar kot, asnjëri prej tyre nuk do të më bindej, ata mezi prisnin të iknin një orë e më parë. Me këtë rast më vjen ndër mend peripecia e vërtetë që hasi im bir, bashkë me të edhe unë, për marrjen e vizës amerikane.

S’më kujtohet për ç’arsye, ka qenë, nëse nuk gaboj, maj i vitit 2000, zyra konsullore e Ambasadës Amerikane në Tiranë përkohësisht nuk funksiononte dhe të gjithë ata që ishin fitues të Lotarisë, në një datë të caktuar - tani as ajo datë nuk më kujtohet - duhej të shkonin në Athinë, për t’i kryer formalitetet e marrjes së vizës

në zyrën konsullore amerikane atje. Ky fakt më zuri në befasi, im bir nuk kishte udhëtuar asnjëherë jashtë vendit, më duhej ta shoqëroja e, mbi të gjitha, dilte nevoja që ai të pajisej me një vizë shengen të lëshuar nga Ambasada Greke. Kur të vjen tersi, thuhet, hapi derën. Qëlloi që ato kohë edhe Ambasada Greke në Tiranë, për shkak të shkeljeve, që ishin vërejtur atje në dhënien e vizave, si flitej, e kishte shtrënguar dorën dhe marrja e një vize paraqitej pothuajse e pamundur.

Shtoj këtu se ato kohë, unë vetë ndodhesha në prag të dy veprimtarive të rëndësishme për mua. E para, një ftesë për të marrë pjesë në një veprimtari, që do të zgjaste plot tetë ditë në Nisë të Francës. Veprimtaria përkonte me datën kur im bir duhej të ndodhej në Athinë, rrjedhimisht edhe unë bashkë me të. Nuk u mendova gjatë, i njoftova mikpritësit e mi se për një arsye të fortë vetjake, fatkeqësisht për mua, nuk mund të merrja pjesë. Më pas nuk m'u dha rasti asnjëherë të shkoja në atë qytet të famshëm turistik.

Veprimtaria e dytë ishte pjesëmarrja në një udhëtim nëpër Europë, me atë që u quajt "Treni i Letërsisë - 2000", që niste në Lisbonë të Portugalisë më 2 qershor të atij

viti, në itinerarin e dikurshëm të Ekspresit Jug-Veri dhe anasjelltas, të *La Belle Epoque*.

Në këto kushte bëra çmos që në datën e caktuar të ndodhesha bashkë me djalin në Athinë. Pasi dështova ta zgjidhja këtë punë me miq e të njohur të mi shqiptarë, që sipas meje i kishin mundësitë të ndërmjetësonin në Ambasadën Greke, ndërmora jo pa druajtje dhe me një ndjesi turpi, një veprim të pazakontë: iu drejtova për ndihmë mikut tim të çmuar, zotit Patrick Christman, ish-ambasador i Francës asaj kohe në Tiranë. Përfitoj nga rasti t'i shpreh këtu edhe një herë zotit Christman mirënjohjen time të thellë. Falë ndërmjetësimit të tij në rrugë zyrtare pranë konsullit grek, u bë e mundur që im bir të pajisej me vizë.

Një ndërlikim i kotë në dukje, por tepër serioz në thelb, na priste në aeroportin e Athinës, ku im bir, për moshën e tij të re, i ngjalli dyshime oficerit që vuloste pasaportat para se të na lejonte të kalonim matanë. Duke e ditur tashmë se çfarë mund t'u ndodhte shqiptarëve nëpër aeroporte, unë e kisha parashikuar këtë. Në Greqi, sapo më ishte botuar një roman, e kisha marrë me vete dhe për të shuar dyshimet, që i lindën oficerit, vajta menjëherë pranë sportelit, i fola në frëngjisht, i thashë se isha babai i

këtij djali dhe i tregova kopjen në greqisht të librit. Doli se oficeri kuptonte frëngjisht. Dhe ndryshoi qëndrim, u bë miqësor, na vulosi pasaportat, na uroi qëndrim të këndshëm në vendin e tij dhe na lejoi të kalonim në anën tjetër. Atje na priste Violeta, bashkëshortja e djalit të tezes së Lilit, dr. Pandi Pepivanit, i cili kishte punuar ca kohë si mjek në një spital të Athinës. Të nesërmen, në orën e caktuar, u paraqitëm pranë godinës së Ambasadës Amerikane në Athinë.

Doriani u nis për në SHBA pas disa ditësh. Unë dhe Lili u qetësua përfundimisht, kur tek rrinim në shtëpi me mendje të ngritur, na mbërriti një telefonatë nga Nju-Jorku. Në anën tjetër doli Elda. Na tha se ata të tre, domethënë ajo, Danieli dhe Dori, ndodheshin duke pirë kafë në një lokal në *Manhatan*. Pikërisht në atë lokal, sipas një marrëveshjeje të arritur qysh më parë, Dori do të fillonte punë që të nesërmen si kamerier.

Më 2 qershor, unë mbërrita në Lisbonë, prej nga ndërmora udhëtimin më fantastik të jetës sime. Hollësitë dhe mbresat e këtij udhëtimi i kam dhënë në sprovën e botuar si libërth më vete, me titull: “Një ëndërr europiane mes Al Paçinos dhe Kavabatës” (“Toena”, 2001, 2019).

3.

Për herë të dytë kam vajtur në SHBA nga fundi i dhjetorit të 2008-s. Ai ka qenë një vit i jashtëzakonshëm për mua në të gjitha pikëpamjet kur, veç të tjerash, më se një herë m'u desh të merrja vendime jo të lehta. Në retrospektivë, nuk jam në gjendje të them nëse ato kanë qenë zgjedhjet e duhura, apo do të kishte qenë më mirë të vendosja ndryshe. Sidoqoftë, në fillim të atij viti, mua as që më shkonte në mendje se fundi i po atij viti do të më gjente në Nju-Jork.

Sapo kisha botuar romanin “Jetë në një kuti shkrepësesh” (2007) dhe në kokë më vërtitej ideja e një romani të ri (“Bolero në vilën e pleqve”). Mendoja se këtë libër do të nisja ta shkruaja në kushte, po them optimale. Pas një aplikimi, me ndihmën e zotit Joachim Roehm, u ftova nga Kultur Kontakt-Austria, që atëherë drejtohej nga zonja Annemarie Turk, t'i kaloja dy muajt e

parë të atij viti (janar-shkurt) në një rezidencë për shkrimtarë dhe artistë në Vjenë. Kisha dëgjuar se zakonisht këta muaj ishin ndër më të ftohtit në kryeqytetin austriak, çka nuk ndodhi, por unë mbeta shumë i kënaqur me kohën, që më propozohej për një arsye tjetër. Atë vit, si mësova, do të isha i ftuar edhe në dy rezidenca të tjera shkrimtarësh, në Belgjikë e në Gjermani, nuk doja t'i çoja dëm as këto raste, kështu që ky doli varianti më i përshtatshëm për mua.

Ata dy muaj në Vjenë kanë qenë ndër më të mrekullueshmit e jetës sime. Në pikëpamje të krijimtarisë, puna me romanin e ri më shkoi mjaft mirë, deri nga mesi i muajit shkurt. Atëherë, të tjera “zhvillime” e mënjanuan, e nxorën “jashtë loje” romanin e ri.

Rezidenca ndodhej në katin e tretë të një pallati, pranë një mënge të Danubit. Ishte një apartament i bollshëm me një dhomë gjumi, e pajisur me shtrat dopjo. Në dhomën ngjitur me të, që unë e përdora si studio, kishte gjithashtu një shtrat, një tryezë pune e disa karrige. Vinin pastaj anekse të tjera, ku veçoj sallonin e ngrënies, muret e të cilit ishin zbukuruar me piktura. Si rregull apartamenti u vihej në dispozicion

njëkohësisht dy rezidentëve. Meqë unë u thashë mikpritësve të mi se do të shkoja atje me bashkëshorten, po ndoshta ngaqë për janarin dhe shkurtin ata nuk kishin ndonjë kërkesë tjetër, i gjithë apartamenti u vu në dispozicionin tim. Kushte luksi, pra, që mundësuan gjithçka të bukur të atyre dy muajve. Më e bukura: një ditë Elda na njoftoi se ajo dhe Danieli, pas tetë vjetësh bashkëjetese, kishin vendosur diçka të rëndësishme. Me rastin e Shën Valentinit do të vinin te ne për të bërë martesën zyrtare, thënë ndryshe celebrimin, në Bashkinë e Vjenës.

Kështu ndodhi vërtet. Me atë rast, nga Nju-Jorku mbërritën përveç Eldës, Danielit dhe Dorianit, nëna e Danielit, dhe një shok i afërt i tij, emri i të cilit nuk më kujtohet. Nga Tirana erdhi vëllai im i vogël, Artani me bashkëshorten Tatjana, dhe djali i tyre Endri. Vëllai tjetër Rolandi, nuk mundi të vinte.

Kuptohet, pas mbërritjes së tyre e ndërpreva punën me romanin e ri. Iu dorëzova asaj që quhet “dembeli e ëmbël”, kur ke dëshirë të shohësh ëndrra me sy hapur. Unë dhe Lili nuk po shihnim ndonjë ëndërr me sy hapur, sido që edhe tani, kur ndodh t’i

kujtojmë ata dy muaj, na përfshin një mall, na duket sikur gjithçka përjetuam në Vjenë, sipas meje kryeqyteti më miqësor në botë, s'ka qenë gjë tjetër veçse një ëndërr. Temë tjetër edhe kjo, del jashtë synimit të këtyre shënimeve. Por nuk mund të mos shënoj se disa mrekulli historiko-kulturore të Vjenës, për shembull Pallati i Perandoreshës Sisi - Shënbrun etj., pata mundësi t'i "zbuloja" pas mbërritjes së ekipit nga Nju-Jorku. Fill pas ceremonisë së celebrimit, të nesërmen apo të pasnesërmen, ndërmorem edhe një udhëtim me tren për në Budapest. Atje na priti një i ftohtë i acartë. Më kujtohet se shpalljen e pavarësisë së Kosovës, më 17 shkurt 2008, e kam ndjekur në televizor në hollin e një hoteli në Budapest.

Vij kështu në pikën kur nisi për ne, domethënë për mua dhe për Lilin, një ndryshim rrënjësor i ekzistencës. Në një nga ato ditë, para se grupi i të ardhurve nga Nju-Jorku të merrte rrugën e kthimit, Elda, kurdoherë befasuese, na parashtroi një ide të re. Sipas saj tashmë ishte koha dhe ishin pjekur kushtet që edhe ne, domethënë unë dhe Lili, të shkonim pranë tyre në Amerikë. Prandaj, me t'u kthyer në Nju-Jork ajo do të merrej me procedurat e bashkimit familjar.

Të them të drejtën, me kalimin e viteve, sidomos pas largimit nga kjo botë të nënës sime, e cila gjithë jetën kishte qëndruar me mua, ndodhte të më ngacmonte kjo ide. Me kalimin e viteve unë nuk ushqeja më asnjë iluzion se fëmijët do të ktheheshin prapë në vendlindje, për të ndërtuar jetën e tyre. Një herë të vetme që ata erdhën të dy bashkë mezi pritën të kalonin ditët e të iknin sërish. Dhe ma bënë të qartë: ata nuk donin të ktheheshin më. Një subjekt gjithnjë aktual ky, e kam prekur në njëfarë mënyre edhe te romani im i fundit “Gënjeshtarë të vegjël” (“Toena”, 2019). Do të dëshiroja të ndalesha edhe këtu. Është e dhimbshme çka po ndodh me zbrazjen e Shqipërisë, plakjen e saj, për këtë është folur e vazhdon të flitet. Unë nuk mund t’u shtoj asgjë atyre që janë thënë e vazhdojnë të thuhën. Përveç, ndoshta, përvojës sime.

Pas vdekjes së nënës, kur mbeta vetëm me Lilin, edhe unë, edhe ajo zumë ta ndienim gjithnjë e më shumë mungesën e fëmijëve. Pa asnjë shpresë se ata do të ktheheshin një ditë. Në fillim, kur ata ishin larguar njëri pas tjetrit, me gjithë dhimbjen dhe trishtimin që më pushtoi, bëra çmos të pajtohesh me gjendjen e re,

t'i jepja zemër edhe Lilit. Mirëpo, thellë në vetvete isha vazhdimisht i shpërqendruar. Jo thjesht sepse më mbyste malli. Netëve më dilte gjumi, ndieja frymëmarrjen e Lilit pranë meje, dhe në errësi më pushtonte një gjendje ankthi, një ndjesi braktisjeje. Pa asnjë përfytyrim se çfarë na gatiste e ardhmja në stinën e pleqërisë së thellë, nëse do ta mbërrinim këtë stinë. U ishim gjendur dhe i kishim varrosur vetë të dy prindërit, edhe unë, edhe Lili, nëna ime madje vdiq në krahët e mi, ia kisha mbyllur edhe sytë në çastin e fundit. Po ne, a do të gjendej njeri për të na mbyllur sytë në çastin e fundit?

Ndonjëherë bëja me Lilin një shaka, që asaj nuk i pëlqente. “Mos e çaj kokën, - i thosha, - kur të vijë ajo kohë ka plot azile, do të kemi pensionet dhe kështu puna zgjidhet lehtësisht.”

Kësaj gjase nuk i besoja as vetë. Më saktë, më dukej një gjasë e pamundur, të thuash se jeta mbetet në vend, të thuash se koha për të cilën flas nuk do të vinte kurrë për ne. Pastaj shakanë e hidhur e shtjelloja me vete.

“Po mirë, xhanëm, - thosha, - përse Lili mërzhitet kaq shumë, ç'të keqe ka t'i ngrysësh ditët në një azil?”

Në Spartën e lashtë, me ç'mbaj mend të kem dëgjuar qysh kur isha nxënës në shkollën shtatëvjeçare, kur prindi plakej dhe nuk ishte më i aftë të kujdesej për veten, i biri e merrte në krahë, e çonte në mal, e braktiste në një guvë, i linte një poçe me ujë, dhe kjo ishte një praktikë e pranuar si normale nga shoqëria e kohës. Lutem të mos merret thjesht si një shaka cinike nga ana ime pohimi se që nga mbyllja në një guvë, deri te mbyllja në një azil pleqërie, shoqëria njerëzore ka bërë një hap domethënës në zgjidhjen e problemit. Azili është sot një praktikë e të gjitha shoqërive, të përparuara, shumë të përparuara apo më pak të përparuara, të prapambetura etj. Një praktikë e njohur edhe në Shqipërinë tonë të dashur që, siç e përmenda, po zbrazet pandalshëm nga ata që janë forca jetësore, përtëritëse e kombit, e ku po mbeten vetëm të moshuar. Pra, çfarë zgjidhje tjetër më të mirë përveç azilit mund të ketë në një vend, ku po mbeten vetëm të moshuar? Mirëpo te ne, shpesh, mbyllja në një azil perceptohet jo mirë. Shpesh, për persona të ndryshëm, të njohur ose të panjohur publikisht, kam lexuar të përdoret në një kontekst negativ shprehja: “Në fund i mbylli ditët i braktisur

në një azil”. Gati-gati sa nuk thuhet “i mbylli ditët në një guvë”.

Çështje tradite, zakonesh, mënyrë jetese, e lidhur me të kaluarën e largët e të afërt dhe, doemos, me të sotmen. Një “terren”, që u përket ta thonë fjalën e tyre studiuesit, specialistët, ku unë mund të sjell gjithnjë vetëm përvojën time. Dhe përvoja ime është kjo: ndoshta frika se edhe për mua një ditë do të mund të thuhej gati-gati se “i mbylli ditët në një guvë”, pas vdekjes së nënës, shpesh mendoja se në një të ardhme, për mua dhe Lilin nuk mbetej rrugë tjetër përveçse të shkonim pranë fëmijëve, në Amerikë. Në këtë kuptim, projekti i Eldës për një bashkim familjar nuk më habiti. Thjesht m’u duk i parakohshëm. Vërtet, Lili tashmë sapo kishte dalë në pension, ndërsa unë disa vite përpara saj, por ishim ende larg asaj që e quajta stinë e pleqërisë së thellë, kur përfytyroja se ndoshta do të ishte e nevojshme të shkonim të vendoseshim pranë fëmijëve. Jeta jonë tashmë rridhte e qetë, pa probleme, pa kokëçarje, këto i përkisnin së kaluarës. Për më tepër, unë isha në kulmin e punëve, me botime librash brenda e jashtë vendit etj. etj., s’dua të zgjatem.

Edhe diçka: propozimin e Eldës, megjith-
ëse ajo e tha shumë seriozisht, unë nuk e
mora fort seriozisht. E mora thjesht si një
dëshirë të bukur, që s'dihej se kur mund
të realizohej. Në këtë pikë gabohesha, nuk
e mendoja se punët do të precipitonin aq
shpejt. Pak kohë pasi ishim kthyer nga
Vjena, Elda na njoftoi se ata i kishin kryer
procedurat e bashkimit familjar. Them “ata”
sepse, siç ishte e natyrshme, në plan të parë
doli im bir, Doriani. Dokumentet që na u
përcollën neve dhe Ambasadës amerikane
në Tiranë ishin plotësuar dhe firmosur nga
Dori, ai bëhej garant për ne duke dëshmuar
hollësisht se i plotësonte të gjitha kërkesat
që përcaktoheshin nga ligji amerikan për
bashkimin familjar.

Fëmijët gjendeshin gjithmonë në Queens,
por ndërkaq më në lindje, në breg të Oqeanit
Atlantik, në një zonë të quajtur “Rockaway
Beach”, pranë aeroportit *JFK*, ku mund të
mbërrije e shumta për njëzet apo njëzet e
pesë minuta me makinë. Banonin në dy
pallate të ndryshme, rreth njëqind metra
larg njëri-tjetrit, afër bregut të oqeanit.
Për të dalë te shëtitorja përgjatë bregut
(boardwalk) duheshin vetëm pak minuta
në këmbë. Në këto banesa fringo të reja,

siç thuhet, të ndërtuara e të populluara rishtazi, ata sapo ishin vendosur.

Apartamenti i Eldës ndodhej në katin e katërt të pallatit, në pozicion të prirët ndaj oqeanit, i Dorit në katin e dytë, në pozicion ballor. Elda dhe Danieli vazhdonin të punonin në aeroport, me detyra tashmë të tjera, ndërsa gjendja e Dorit, që nga vajtja ime e parë atje, kishte ndryshuar rrënjësisht.

Ende pa ikur në Amerikë, ai ishte i pakënaqur që unë s'kisha mundur të ndërhyja për ta rregulluar në një fakultet tjetër dhe jo në Universitetin Bujqësor, në degën veterinari, të cilën nuk e pëlqente. Mirëpo kjo i doli më për mbarë. Kur ai u regjistrua në Kolegjin universitar në Queens, për të vazhduar studimet e ndërprera në mes të vitit të dytë, iu njohën të gjitha provimet e shlyera në UBT, i vetmi institucion i lartë arsimor në Shqipëri, diplomat e të cilit njiheshin edhe jashtë vendit. U diplomua në degën Biologji, dhe pasi mbaroi edhe Akademinë e Policisë, u punësua në NYPD, Departamenti i Policisë së Nju-Jorkut, ku shërben edhe sot.

Apartamenti i Dorit ishte i bollshëm. Kishte dy dhoma, njëra më e madhe (ku u

vendosëm unë dhe Lili), tjetra më e vogël, një holl (livingroom), gjithashtu shumë i bollshëm, me aneksin e kuzhinës etj. Në gjithë atë apartament, ende beqar, Dori banonte vetëm. Në Vjenë më kishte thënë se njihte një vajzë, ishte ruse dhe e quanin Irina. Tashmë bashkëshortja e tij.

Formalitetet për marrjen e vizës i kryem në muajin qershor të atij viti. Meqë fjala ishte për bashkim familjar, sipas rregullit na u desh të paraqisnim certifikata zyrtare që të dëshmonin se nuk kishim asnjë problem me drejtësinë në Shqipëri, certifikata të vaksinimit tonë për disa sëmundje, të kryenim kontrole mjekësore në një klinikë të autorizuar nga Ambasada. Mua, që kisha studiuar në rininë time për tre vjet në Kinë, veç të tjerave, m'u kërkua të paraqisja edhe një dëshmi të lëshuar nga policia e Pekinit, po e quaj certifikatë “pastërtie”, që të vërtetonte se gjatë periudhës së studimeve atje, nuk kisha pasur probleme me policinë. Një telash më vete ky. Kur vajta në Ambasadën e Kinës që ata të ndërmjetësonin për të ma siguruar këtë dokument, duke u shpjeguar edhe arsyen përse më duhej, konsulli kinez më tha se ata nuk mund të ndërhyjnë për

çështje të tilla, më duhej të merresha vetë. Për fat, në atë kohë, kunata ime Tatjana, bashkëshortja e vëllait tim të vogël Artanit, punonte në ambasadën tonë në Pekin. Ajo më ndihmoi ta siguroja edhe këtë dokument me interesimin e konsullit tonë dhe, më në fund, në ditën dhe orën që na u caktua, u paraqitëm në ambasadë për intervistën. Atje më priste një tjetër befasi.

Certifikatën time të “pastërtisë” e kishte lëshuar Universiteti i Pekinit, ku kisha studiuar. Konsulli amerikan më shpjegoi se kjo nuk ishte e mjaftueshme, duhej një dokument nga policia e Pekinit dhe jo nga universiteti, pra hëpërhë nuk mund të ma jepte vizën. Ndërsa Lilit i tha se për të s’kishte asnjë problem. Varej prej saj nëse dëshironte ta merrte vizën tani, apo të priste edhe ajo derisa unë të siguroja dokumentin e duhur.

Lili nuk foli. Në vend të saj foli unë. Me ndërmjetësinë e një vajze shqiptare, që i shërbente si ndihmëse dhe përkthyesë, i thashë konsullit se po të ishte e mundur, bashkëshortes sime t’ia jepte vizën që tani, unë mund të shkoja edhe më vonë. I shpjegova gjithashtu se certifikatën në fjalë e kisha siguruar me interesimin e

drejtpërdrejtë të konsullit shqiptar në Ambasadën Shqiptare në Pekin dhe ia shfaqta habinë time që ai nuk paskej siguruar dokumentin e duhur.

Bashkëbiseduesi im ishte një burrë nja dyzet vjeç, me pamje dashamirëse. Doemos, ai e vuri re që unë u preva dhe duket i erdhi keq. Ishte i prirë të më ndihmonte dhe vërtet më ndihmoi. Por, aty për aty, pa më thënë asgjë, ai i lëshoi Lilit një pusullë, sipas së cilës duhej të paraqitej në ambasadë të nesërmen në orën dhjetë paradite për të tërhequr vizën.

U ktheva në shtëpi me humor të prishur. Së shpejti do të nisesha për në Belgjikë, i ftuar për një periudhë prej një muaji e gjysmë, në një rezidencë shkrimtarësh, në periferi të Brukselit, e dyta për mua gjatë atij viti, pas asaj të Vjenës. Kështu si erdhën punët, më duhej ta anuloja vajtjen atje. Dhe kushedi se sa kohë mund të merrte nxjerrja e një certifikate tjetër, kësaj here nga policia e Pekinit, po të mos përmend se më vinte shumë zor që do të bëhesha i bezdisshëm.

Ndodhi ajo që nuk e prisja. Tek rrinim në dhomë tringëlliu befaz telefoni dhe Lili, që e ngriti, më tha se më kërkonin nga Ambasada Amerikane. Për habinë time më

mbërriti një zë femëror. Ishte ndihmësja e konsullit, vajza që kishte ndërmjetësuar atë paradite midis meje dhe këtij të fundit, si përkthyes.

Ajo më tha se më merrte në telefon me porosinë e konsullit. Më tha edhe se jam e autorizuar, t'ju kërkoj falje në emër të konsullit për shqetësimin e krijuar lidhur me certifikatën e “pastërtisë”. Dhe më shpjegoi se pas bisedës me mua, konsulli ishte këshilluar me kolegë të tij në Ambasadën Amerikane në Pekin dhe ata e kishin siguruar se certifikata e lëshuar nga Universiteti i Pekinit, në përputhje me praktikat që zbatoheshin në Kinë, kishte të njëjtën vlerë me atë të lëshuar nga policia. Kështu që, përfundoi ajo, të nesërmen në orën dhjetë të paraqitesha edhe unë, për të marrë vizën amerikane.

Konsulli më kishte ndihmuar. Të nesërmen pata rastin t'i shprehja mirënjohjen time.

4.

Në javët dhe muajt që pasuan ndodhte të më përfshinte një gjendje pështjellimi, për të mos thënë nervozizmi. Tashmë që gjithçka ishte bërë fakt i kryer, pra do të shkoja të vendosesha në Nju-Jork, te fëmijët, më saktë tek im bir, ia shtroja vetes pyetjen: a kishte qenë ky një vendim i matur nga ana ime?

Lili më qetësoi me një arsyetim praktik: të shkonim njëherë, pastaj me të parë e me të bërë. Kështu e nisëm mirëfilli atë vit aventurën më të madhe të jetës sonë, në përputhje me parimin popullor “me të parë e me të bërë”. Kjo do të zgjaste rreth shtatë vjet, do të kurorëzohej me fitimin e shtetësisë amerikane, që do të vulosej përfundimisht në janar të 2015-s, kur një ditë, përmes postës, na mbërritën në shtëpi pasaportat përkatëse.

Por të kthehem tek ai muaji qershor i vitit 2008. Unë ndodhesha përpara dy

veprimtarive, jo pa rëndësi për mua, që i përmenda më sipër. E para, një qëndrim prej gjashtë javësh në një rezidencë për shkrimtarë dhe artistë në Belgjikë, në periferi të Brukselit. E dyta, një tjetër rezidencë, në muajt nëntor-dhjetor të po atij viti, në Gjermani. Pasi mora vizën, desha t'u shkruaja mikpritësve të mi në Belgjikë e Gjermani, t'u kërkoja të falur që për arsye vetjake nuk do të mund të përfitoja nga ftesa e tyre bujare dhe të nisesha për në Nju-Jork. Ma prishi mendjen Lili. Ajo më tha se ndoshta nuk do të më jepej më kurrë rasti për të vajtur në rezidencat e mësipërme, do të ishte vërtet për të ardhur keq po t'i çoja dëm pa ndonjë arsye të fortë, përderisa vizat tona amerikane ishin të vlefshme deri nga mesi i janarit të vitit pasardhës.

Të njëjtën këshillë ajo ma ka përsëritur edhe disa vite më vonë, në verë të vitit 2012. Atëherë, falë shkrimtarit dhe mikut tim Arjan Leka, mora pjesë bashkë me të në një veprimtari interesante, me pjesëmarrje të disa autorëve dhe me takime letrare në publik ngado që shkuam, organizuar dhe mbështetur financiarisht nga një fondacion gjerman. Veprimtaria zgjati dy javë. Nisi në Split të Kroacisë, vazhdoi në Turqi, në Izmir,

për t'u mbyllur në Tiranë. E përmenda këtë sepse kur Arjani më propozoi të merrja pjesë, unë ngurrova, i thashë Lilit se nuk kisha fort dëshirë të shkoja. Ajo më vuri në dukje të njëjtën gjë si dikur, domethënë se një rast i tillë ndoshta nuk do të përsëritej më për mua. Ka të ngjarë që, pa këtë ndërhyrje për të ma kthyer mendjen, me plogështinë time ta kisha çuar dëm një veprimtari jo aq të zakonshme turistiko-letrare, kështu po e quaj, plot çaste të bukura, si ka qenë, për shembull, një vizitë e rrallë për mua në pallatin e perandorit romak Dioklecian në Split.

I dhashë, pra, të drejtë Lilit, s'kisha arsye të nisesha nxitimthi për në Nju-Jork. Dhe nga mesi i shtatorit u nisa për në Bruksel. Këtu përfitoj të hap një parantezë.

E kam fjalën për rezidencat e mia në vende të ndryshme të Europës. Kolege e kolegë të tjerë shkrimtarë, sigurisht kanë përvojat e tyre, më të pasura se përvoja ime, sidomos më të rejat apo më të rinjtë në moshë. Sepse, me ç'kam pasur rastin të vërej, rezidencat e kësaj natyre, domethënë për krijimtari letrare dhe artistike, kanë për synim kryesisht mbështetjen e shkrimtarëve

dhe artistëve të rinj. Këtë mund ta them së paku për ato rezidenca ku kam bujtur unë. Kalimthi vë në dukje se para disa vitesh kam dëgjuar idenë e krijimit të një rezidence të tillë edhe në Shqipëri, për autorët vendas, por edhe për të ftuar autorë të huaj. Mendohej që një rezidencë e tillë mund të përshtatej, si vend ideal, në mjediset e kalasë së Ali Pashë Tepelenës në Porto Palermo. Kur më ra në vesh kjo dëshirë e bukur, kam qeshur. Mendova: “Shiko-shiko, - do të thonë disa, - ku u paska vajtur mendja gjynahqarëve, s’dashkan hiçgjë...”.

Megjithatë, nga Arjan Leka mësova tani së fundi se, sidoqoftë, diçka e lavdërueshme është bërë, me mbështetjen financiare të Këshillit të Europës dhe organizatës “Traduki”. Prej afër dhjetë vjetësh, shoqata “Poeteka-Tirana in Between”, fton dhe mirëpret në rezidencë në Shqipëri shkrimtarë dhe shkrimtare nga vende të ndryshme.

Rezidenca ime e parë ka qenë në Francë, në nëntor-dhjetor të vitit 1998. Qysh atëherë kanë kaluar më se njëzet vjet dhe, për arsye të shumta, tani kujtesa ime nuk është më aq e kthjellët, sidomos për sa u përket datave. Në këtë kuptim, më vjen keq që, me gjithë dëshirën e përhershme për të mbajtur ditar,

kur as e çoja nëpër mend se do të vinte një ditë dhe kujtesa ime mund të më “mashtonte”, nuk e pata asnjëherë vullnetin për ta kryer këtë punë; vazhdimisht e pa ndërprerje, më duhej të merresha me romanet e mia. Edhe kur ndodhte të ulesha për të mbajtur ditar, mërzhitesha shpejt, hiqja dorë. Por e them pa mëdyshje se për rezidencën time të parë ndërmjetësoi zonja Martine Grelle, atëherë shefe e CNL-së (Centre National du Livre - Qendra Kombëtare e Librit). Kjo ishte një grua e paktë në trup, e qeshur, fatmirësisht për mua i pëlqenin dhe i vlerësonte librat e mi, erdhi madje edhe në Tiranë, në kuadrin e organizimit të asaj që quhej “Les belles étrangères” (Bukuroshet e huaja). Gjatë një qëndrimi në Paris, kur atje sapo ishte botuar romani im “Kufoma”, në frëngjisht me titullin “L’Ombre de l’autre” (Hija e tjetrit). Ajo më ftoi në zyrën e saj në CNL dhe më pyeti nëse dëshiroja të shkoja në një rezidencë shkrimtarësh; mund të ndërmjetësonte për ta realizuar diçka të tillë. Doemos, pranova.

Rezidenca ndodhej në veri të Francës, fare pranë qytetit Lille, fare pranë, gjithashtu, kufirit me Belgjikën, dhe quhej “Villa Mont Noir”. Sot mban emrin e një prej shkrimtareve

më të shquara franceze të shekullit XX, Marguerite Yourcenar. Jo thjesht për nder të kësaj shkrimtareje të madhe. Rezidenca ishte ndërtuar në pronën e familjes Yourcenar me origjinë nga Belgjika, që shtrihej në një hapësirë kodrinore, plot gjelbërim e pyje. Gjatë Luftës së Parë Botërore, për shkak të bombardimeve të ashpra në atë zonë kufitare, të gjitha banesat e familjes ishin rrafshuar, përveç ngrehinës së stallës së kuajve. Kjo e fundit ishte përshtatur për krijimin e mjediseve të rezidencës, e cila sapo ishte përruar dhe atëherë pranonte vetëm shkrimtarë e shkrimtare nga Europa. Kam pasur fatin të jem ndër bujtësit e parë.

Në katin përdhes të godinës gjendej një sallë e madhe, me tavan të lartë, ku organizoheshin veprimtari të ndryshme kulturore e letrare. Një palë shkallë të ngjisnin më sipër te dhomat e rezidentëve, gjithsej tri. Si rregull, “Villa Mont Noir” pranonte njëkohësisht vetëm tre shkrimtarë ose shkrimtare.

Disa hollësira domethënëse, në krye, më domethënësja për mua: mbi derën e dhomës ku u vendosa unë, binte në sy një etiketë me mbishkrimin “Zenon”. Zenon është emri i personazhit kryesor të romanit “L’Euvre

au noir” (fjalë për fjalë “Vepra në të zezë”) të Marguerite Yourcenar-it.

Para disa vitesh, kur punoja ende në Shtëpinë Botuese “Naim Frashëri”, e kisha ndeshur këtë libër në bibliotekën e atëhershme të institucionit, mjaft e pasur për kohën. Nuk më kujtohet me saktësi (gjithnjë i njëjti problem me kujtesën!) se kur më hipi t’i futesha përkthimit të tij, por them se ka ndodhur në ndërkohën midis botimit të dy romaneve të mia të para “Ne të tre” (1985), dhe “Karuseli” (1990). Pas debutimit në përkthim nga frëngjishtja në shqip me ndonjë prozë të shkurtër, kjo ka qenë orvatja ime e parë e mirëfilltë në fushën e përkthimit, orvatje që për disa arsye nuk e çova deri në fund.

Teksti ishte i vështirë për mua, për nivelin tim të njohjes së gjuhës frënge dhe ngeca, për shembull, që në krye, te titulli. “Vepra në të zezë”, nuk ma mbushte mendjen. Rastësisht kam hasur atëherë në gazetën “Drita” se dikush e kishte përkthyer “Zezona”... Iu drejtova një përkthimi nga rusishtja, tekst që e gjeta po në bibliotekën e Shtëpisë Botuese dhe më shërbeu gjatë gjithë kohës për ballafaqim, për krahasim. Përkthyesi rus kishte gjetur një titull që

më befasoi: “Guri filozofik”. Kushdo që e ka lexuar këtë roman të shkrimtares Marguerite Yourcenar besoj do të më japë të drejtë po të pohoj se ky është një përkthim i përkryer i titullit të tij. Ai e jep më së miri përmbajtjen filozofike të librit dhe të protagonistit, që i përket një prej epokave më të trazuara të mesjetës: prift, filozof, mjek, alkimist etj., i cili përfundon me vetëvrasje në burgjet e inkuizicionit, duke fituar kështu lirinë dhe përjetësinë e tij.

Edhe një hollësi. Një dhomë tjetër, në një korridor pak më tutje dhomës sime, mbante një etiketë me mbishkrimin “Hadrien”, personazhi kryesor i romanit “Kujtimet e Hadrienit”, kryevepra e Marguerite Yourcenar-it. Me sa di, nga këto dy romane - do t’i quaja komplementarë - është botuar në gjuhën shqipe libri kushtuar Zenonit. Ai është përkthyer nga ish-kolegia ime në Shtëpinë Botuese “Naim Frashëri”, zonja Donika Omari.

Në orvatjen time prej amatori në fushën e përkthimit, kam pasur fatin të këshillohesha vazhdimisht me mikun tim të vjetër, Edmond Tupja, me të cilin punonim në të njëjtën godinë. Më pas, kur nuk më mbetej më kohë, hoqa dorë nga përkthimi i librit, Mondit më tha se i vinte keq që po çoja dëm

një punë jo të vogël, madje më propozoi ta përfundonim bashkë. Më kot, ndërkaq unë isha i përpirë nga librat e mi.

Duke hequr dorë për arsyen që thashë nga përkthimi, unë vërtet “çova dëm” një punë të madhe, por sidoqoftë, meqë i isha futur kësaj pune në mënyrë, po them, sportive, kjo më kishte dhënë një kënaqësi të veçantë në ballafaqimin tim prej amatori dhe adhuruesi të gjuhës frënge, me një autore të shquar të kësaj gjuhe. Tekefundit, mbërriti një ditë e ky mundim m’u shpërblye. Përvoja e fituar më shërbeu pas disa vitesh të përktheja jo thjesht për qejf, kësaj radhe me porosi, tri vepra voluminoze, që po i përmend sipas radhës së botimit. Këto janë: monografia “Marguerite Duras”, nga Laure Adler (“Albin”, 2001); “Apologji për historinë, ose Mjeshtëria e historianit”, nga Marc Bloch (“Shtëpia e librit dhe e komunikimit”, 2003); “Gramatikë e qytetërimeve”, nga Ferdinand Braudel (“Shtëpia e librit dhe komunikimit”, 2005). Dy autorët e fundit janë historianë të shquar francezë, bashkëthemelues të asaj që quhet Shkolla e Analeve.

Gjatë qëndrimit të “Villa Mont Noir” unë pothuajse nuk shkrova asgjë. Në kokë më vërtitej romani “Ëndrra e Damokleut”, por nuk arrita të hidhja as kapitullin e parë.

Tryeza e punës në vend që të më tërhiqte më largonte, derisa e vendosa. Kur të kthehesha në Shqipëri do të kisha kohë me bollëk për t'u përbullur me të. Këtu më mirë të bëja pak turizëm, nën shembullin e kolegëve të tjerë, që i gjeta atje, një anglez, një polak dhe një francez, që të tre shumë më të rinj se unë. Francezi ishte vendosur në një mjedis jashtë godinës së rezidencës.

Në dispozicion të shkrimtarëve ishte vënë një makinë. Atë mund ta përdorte, me marrëveshje midis tyre, secili nga shkrimtarët. Më kujtohet se te “Villa Mont Noir”, qëndroi për një periudhë njëmuajore edhe nobelistja më e fundit në fushën e letërsisë, polakja Olga Tokarçuk, e cila zëvendësoi bashkëkombësin e saj. E them çiltërsisht, do të kisha dashur që këtë çmim ta kishte marrë Ismail Kadareja, ndonëse shkrimtarit tonë ai nuk i shton asgjë. Por për Olgën, edhe u befasova, edhe m'u bë qejfi. Qysh atëherë, ende e re në moshë, ajo ishte botuar në disa gjuhë të huaja. Unë e çmoja miqësinë e saj ndaj meje, pa e çuar nëpër mend se po rrija me një nobeliste të ardhshme. Veç të tjerash, ajo nuk shfaqte kurrfarë përbuzjeje ndaj alkoolit, kompleksi im i përjetshëm.

I vetmi që nuk u “futej në pjesë” të tjerëve te makina isha unë; s’dija as ta ngisja, as të orientohesha, as ku të shkoja. Për kompensim, ata më ftonin ndonjëherë, kur u tekej, të shkoja diku bashkë me ta. Po të shtoj këtu sidomos disa veprimtari të organizuara nga ana e rezidencës, mund të them se pata rastin t’i bija zonës kryq e tërthor, deri në qytetin verior bregdetar Dunkerk, i famshëm për tërheqjen e disa mijëra trupave britanike në vitin 1940, për të mos u zënë rob apo asgjësuar nga ushtria hitleriane, dhe në krahun tjetër në Belgjikë, deri në qytetin historik Bruges, streha e fundit e Zenonit, ku u zbulua nga Inkuizicioni, u burgos dhe vrau veten.

Ndjesia më e magjishme, që m’u përftua gjatë qëndrimit tim te “Villa Mont Noir”, për të cilën kam folur edhe në një shkrim tjetër vite të shkuara, por që dëshiroj ta përsëris: kalimi i kufirit midis Francës dhe Belgjikës. Për të shkuar deri atje më duheshin nja dhjetë minuta në këmbë. Asnjë rojë, asnjë tra, asnjë kontroll dokumentesh. Ky ishte Perëndimi, hapësira e demokracisë dhe e lirisë. Ditëve të diela, shihja në varg dhjetëra makina nga rruga e anës franceze, me njerëz që vinin në anën belge për të blerë çokollatë,

çokollata në Belgjikë qenkej më e lirë dhe e një cilësie më të lartë se ajo që prodhohej në Francë. Sa herë që e kaloja kufirin në këmbë, i mrekulluar, thosha me vete: “A do të vijë një kohë që edhe andej nga ne të bëhet kështu?”.

Ishte viti 1998. Në një të shkuar jo të largët, te ne njerëzit vriteshin pa mëshirë në orvatjet për të kaluar kufirin, trupat e të vrarëve regjimi i shëtiste rrugëve për t’ua futur tmerrin të tjerëve. Ndërkaq, shumë gjëra kishin ndryshuar rrënjësisht. Por edhe sot, edhe tani që po hedh këto radhë, në mesin e vitit 2019, me gjithë ndryshimet e tjera rrënjësore, nëse jo në pikëpamje gjeografike, jemi ende shumë larg hapësirës së ëndërruar europiane. Edhe sot e kësaj dite, ashtu si para gati tridhjetë vjetësh, parulla më aktuale te ne mbetet: “E duam Shqipërinë si gjithë Europa!”.

Rezidenca ime e dytë ka qenë disa vite më vonë në Berlin. Atëherë sapo ishte botuar në gjermanisht, në Zvicër, nga Shtëpia Botuese “Ammann Verlag” në Zyrih, romani “Lëkura e qenit”, përkthyer nga zoti Joachim Roehm.

Në vitin 2006, me ndërmjetësinë e të ndjerit Egon Ammann, bos i shtëpisë botuese (ndarë nga kjo jetë para disa vitesh) dhe atasheut të shtypit të kësaj

shtëpie botuese, zonjës Ulla Steffan, u ftova nga Litterarisches Colloquium Berlin. Si rezidencë shërbente një ndërtesë e para Luftës së Dytë Botërore. Një sallon i madh, ku organizoheshin veprimtari kulturore dhe letrare, të priste sapo futeshe në godinë. Kjo ngrihej në një nga zonat më të qeta të Berlinit, buzë liqenit Wannsee. Dikur kishte qenë pronë e një familjeje të pasur hebreje, të shfarosur nga nazistët. Mikpritësit më vunë në dispozicion një suitë në katin e fundit, prej nga mund të dilje sipër, ku të shfaqej një pamje mbresëlënëse, veçanërisht netëve, me llamburitjen e dritave.

Me rastin e vajtjes sime në Berlin, Ambasada Gjermane në Tiranë, më mundësoi të ndiqja një kurs intensiv njëmuajor të gjuhës gjermane. Ka qenë një përvojë e paharruar për mua. Kursi zhvillohej çdo paradite në një nga klasat e Fakultetit të Gjuhëve të Huaja, me nja pesëmbëdhjetë djem e vajza, shumica gjimnazistë e gjimnaziste, këto të fundit në numër më të madh. Dhe unë gjyshi i tyre, që zija vend i vetëm, në një bankë në fund të klasës.

Gjatë atij muaji u përpoqa të mësoja me zell të jashtëzakonshëm. Sedra nuk më lejonte të shkoja i papërgatitur në mësim, megjithëse merrja pjesë shumë rrallë dhe

mësuesja, një zonjushë simpatike, nuk më ngacmonte. Në shtëpi, nuk merresha me asgjë tjetër përveç gjermanishtes. Mësoja shpejt, por... po aq shpejt harroja! Dhe më ndodhi diçka e çuditshme. Netëve, nëpër gjumë, flisja me veten në gjuhën kineze, m'u rizgjuan vatrën e dikurshme të gjuhës kineze, të cilën, ndërkaq, pothuajse e kisha harruar. Diçka e ngjashme më ndodhi edhe më vonë, pas disa vitesh, në Nju-Jork. Për gati shtatë vjet radhazi, iu futa kësaj here pa ndihmën e askujt, në mënyrë autodidakte, mësimit të gjuhës angleze. Dhënia provim e kësaj gjuhe ishte një nga kushtet për marrjen e shtetësisë amerikane, por nuk e kam fjalën këtu. Kujtoj se edhe kur rropatesha me anglishten në një moshë tashmë mjaft të tejkaluar për mësimin e gjuhëve të huaja, netëve më pluskonin fjalë dhe shprehje nga gjuha kineze!

Falë këtij kursi, kur mbërrita në Berlin, në njëfarë mënyre, isha në gjendje të komunikoj edhe kur bridhja i vetëm nëpër qytet, kur udhëtoja me tren apo me autobus, ose kur shkoja diku, fjala vjen në ndonjë ekspozitë apo shfaqje, si ka qenë, për shembull, një koncert i mrekullueshëm i Orkestrës Simfonike të Berlinit. Por nga qëndrimi im në rezidencë, veçoj dy

“episode”: i pari (për humor) ka lidhje me suitën ku më vendosën për të bujtur; i dyti, me një veprimtari që u organizua posaçërisht për mua.

Sa herë që hyja e dilja në suitë, e pamundur të mos më shkonin sytë te diçka jo fort e zakonshme: një njollë e madhe mbi qilimin e dhomës. Kjo u bë shkak që me kohë, të merrja vesh se nja dy vjet përpara meje, në atë suitë paskej qëndruar si i ftuar një nga shkrimtarët e sotëm francezë më në zë, Michel Houellebecq. Kisha lexuar prej tij romanin “Les particules élémentaires” (Grimcat - ose thërrmijat - elementare), kisha pasur madje edhe një propozim për ta përkthyer në gjuhën shqipe, çka nuk ndodhi sepse isha vazhdimisht i zënë me librat e mi. Mësova gjithashtu diçka zbavitëse: njolla e madhe mbi qilimin e dhomës ishte një gjurmë e lënë aty nga... qeni i shkrimtarit!

“Episodi” i dytë, një veprimtari për mua duke marrë shkas nga romani “Lëkura e qenit”, atëherë i sapobotuar në gjermanisht. Me atë rast, në rezidencë erdhi botuesi i librit, i ndjeri Egon Ammann-i, si dhe atasheja e shtypit e shtëpisë botuese, zonja Ulla Steffan-i. Kësaj i pëlqenin shumë librat e mi dhe bëri çmos t’i mbështeste me publicitet. Gjej rastin t’i shpreh mirënjohjen time.

Doemos, erdhi edhe përkthyesi Joachim Roehm-i. Ai lexoi për të pranishmit një kapitull të romanit, ndërsa unë iu përgjigja pyetjeve të tyre. Përfitoj këtu të shpreh një mirënjohje të veçantë për zotin Roehm. Jo thjesht sepse ai përktheu - shkëlqyeshëm thonë njohësit e gjuhës gjermane - dy nga romanet e mia. Ai më ka pritur më se një herë në shtëpinë e tij në Shtutgart, më ka shëtitur nëpër Gjermani nga veriu në jug e nga lindja në perëndim, më ka shoqëruar në veprimtari të shumta letrare në qytete të ndryshme të Gjermanisë, e në vende të hapësirës gjermanishtfolëse etj., që unë s'do të kisha pasur rastin kurrë t'i shihja. Veçoj këtu një natë në Lajpcig, ku rrethanat e sollën të flija në një dhomë ku kishte fjetur dikur Heinrich Heine.

Përtej këtyre dy "episodeve" nuk më kujtohet ndonjë gjë tjetër e veçantë nga qëndrimi im në Litterarische Colloquium Berlin. Sipas një llogarie që bëj tani, më del se atje duhet të kem pasur nëpër duar romanin "Te porta e Shën Pjetrit".

5.

Kronika e rezidencave të mia letrare mbyllet në vitin 2008, kur sapo isha pajisur me vizën amerikane. Në fillim, në Belgjikë, në muajin shtator. Më pas, në nëntor-dhjetor, në ishullin Sylt të Gjermanisë.

Përvojën time në këto dy rezidenca e kam përmbledhur në një shkrim që m'u kërkua atëherë, dhe unë e përpilova gjatë kohës së qëndrimit në Sylt. I çrregullt dhe i pakujdesshëm, si kam qenë kurdoherë, këtë shkrim të përkthyer në gjermanisht, gjithnjë nga zoti Joachim Roehm, unë jo vetëm nuk e ruajta, por e kisha harruar fare. Mirëpo doli se Joachim-i, me përpikërinë e tij prej gjermani, e kishte ruajtur, madje kishte ruajtur edhe origjinalin në shqip. Prandaj, në mbyllje të kësaj kronike, e shoh me vend të riprodhoj pikërisht artikullin në fjalë, me titullin e tij original "Një mjedis mikpritës i magjishëm".

"Tani që po shkruaj këto radhë ndodhem në ishullin Sylt, në veri të Gjermanisë. Miqtë

e mi, kur u thashë se do të shkoja në Sylt për një muaj, deri nga fundi i dhjetorit të këtij viti, më paralajmëruan të merrja me vete rroba të trasha dimërore: në ishull bënte shumë ftohtë, frynte erë dhe binte shi. Deri më sot, fillimi i muajit dhjetor, nuk ka bërë aq ftohtë, s'ka pasur erëra të forta dhe ka rënë pak shi. Ndoshta efekt i ngrohjes globale. Po ndoshta për fatin tim.

I kam të gjitha arsyet të ndihem i përkëdhelur nga fati këtë vit. Mbi të gjitha, përfundova romanin tim të ri ('Bolero në vilën e pleqve'). Datën e përfundimit e mbaj mend mirë, jo vetëm sepse qysh atëherë ka kaluar vetëm një muaj e gjysmë. E mbaj mend mirë, sepse ndodhesha në Belgjikë, në një nga rezidencat Passa Porta, te 'Villa Hellebosch', në rrethinat e Brukselit. Sapo kisha shënuar vendin dhe datën e përfundimit të librit, 20 tetor 2008, kur për rastësi, në studion ku punoja, u futën Alexandra dhe Anne. Për ata që nuk kanë qenë te 'Villa Hellebosch', pra nuk e dinë se kush janë këto dy zonja, shënoj se Aleksandra, skulptore, një grua energjike, është përgjegjësjja e rezidencës. Ana, kujdestarja dhe kuzhinierja, që përgatiste ca darka të mrekullueshme.

Në të vërtetë nuk e kisha menduar se do ta mbaroja romanin tim në Belgjikë.

Kisha filluar ta shkruaja në Shqipëri nga gjysma e dytë e vitit 2007, me ndërprerje të shumta. Në vitin 2008 u gjenda, së bashku me bashkëshorten, për dy muaj (janar-shkurt) në një rezidencë për shkrimtarë në Vjenë, i ftuar nga Kultur Kontakt-Austria. Në këto kushte, i shkëputur nga çdo ngacmim i jashtëm, munda të shkruaja një pjesë të rëndësishme të romanit dhe formova bindjen se do të mund ta çoja deri në fund. Lajmi i akordimit të dy bursave për vitin 2008, nga ana e LCB (Litterarische Colloquium Berlin), më erdhi pikërisht kur gjendesha në Vjenë dhe, midis rezidencave që m'u propozuan, zgjodha Brukselin dhe Syltin. Tashmë, me këto dy mundësi të reja për të punuar qetësisht, nuk e vija më në dyshim se do ta përfundoja librin e ri, me gjasë nga fundi i vitit, kur të gjendesha në Sylt. Mirëpo, ndryshe nga parashikimi, e përfundova në Belgjikë.

Te "Villa Hellebosch" mbërrita më 15 shtator, natën. Vetëm të nesërmen në mëngjes munda të shihja ku ndodhesha. Për forcë zakoni gjumi më doli herët. Vështitë, një bluzë, këpucët sportive dhe dola jashtë. Qëllimi im, po të huazoj një term që e përdorin ushtarakët, ishte të kryeja një rikonicion, pra të shihja vendin për të

vendosur se ku mund ta bëja vrapin tim të përditshëm mëngjesor. Pamja që m'u shfaq ishte e mrekullueshme. Një vilë hijerëndë, me çati të lartë, e rrethuar në njërin anë nga një pyll me drurë shumë të lartë e të drejtë, njëqindvjeçarë, si mësova më pas. Kjo ishte ana ku shihte apartamenti im, në katin përdhes. Nga ana tjetër shtrihej një kopsht me mollë e dardha, gështenja e arra, livadhe mbuluar me bar, një bimësi e dendur, e gjelbër, me lloj-lloj drurësh, ku kohë më kohë të dilte përpara me vrap ndonjë lepur. Në drejtimin e kundërt dilje në rrugën automobilistike, që e përshkonte zonën duke lënë anash saj shtëpitë e fermerëve, ara të mbjella me misër ende të pakorrur, livadhe në rrëpirën e kodrës. (Hellebosch, më shpjeguan, në gjuhën flamande do të thotë pylli mbi kodër).

Atë mëngjes, kur u ktheva në Vilë, u njoha me dy banorë të tjerë, të cilëve mjerisht nuk ua mbaj mend emrat, megjithëse i shënova diku. Ishin dy qen, njëri i bardhë, tjetri i zi, femra. Nuk i njoh qentë, kam pasur dhe kam frikë prej tyre. Kështu më ndodhi edhe atë ditë. Sapo më panë ata më lehën, dhe unë u tremba, dhe nga vila dolën menjëherë Aleksandra dhe Paul-i, bashkëshorti i saj. Më thanë të mos trembesha, qentë ishin

tepër miqësorë. Më pas me të bardhin u bëmë miq, më lejonte ta përkëdhelja. Tjetra, e zeza, kishte më shumë frikë nga unë, sesa unë nga ajo; më rrinte larg.

Një muaj e gjysmë qëndrimi te “Villa Hellebosch” do të mbetet brenda meje në trajtat e një qetësie të thellë, që trazohej kohë më kohë nga zhurma e pyllit. Dhe klithmat e zogjve. Tani nuk habitem që në atë mjedis, ku njeriu ndihet pjesë e natyrës, arrita ta mbaroja romanin e ri.

Në fillim, në vilë gjeta Chengerain, poet dhe skenarist nga Zimbabve, me banim në Suedi. Por ky nuk qëndroi gjatë, rreth një javë pas mbërritjes sime u largua për në Zvicër, në kuadrin e një projekti kinematografik. Në apartamentin e lënë bosh prej tij, përballë meje, u vendos nja dhjetë ditë më vonë shkrimtarja gjermane Katia Langer-Muler. Më pas erdhi edhe shkrimtarja holandeze Mariane Bozet. Por edhe këto nuk qëndruan gjatë. Katia, e botuar në 23 vende të botës, një nga shkrimtaret e sotme gjermane më në zë, kishte ardhur me rastin e botimit të njërit prej romaneve të saj në gjuhën flamande. Mariana, për t’i dhënë dorën e fundit një libri të ri me tregime. Të dyja u larguan në të njëjtën ditë dhe unë mbeta përsëri vetëm, me mbresat e bukura, që më lanë për aq ditë sa u njohëm.

S'më mbetej gjë tjetër veç të vazhdoja regjimin tim të përditshëm. Në orën 7:30 gjendesha jashtë. Drita sapo zbardhte dhe, në mot të kthjellët, si qëlluan në shumicën dërrmuese ditët e qëndrimit tim në Vilë, kisha mundësi të ndiqja lindjen e magjishme të diellit. Deri te vendi që unë e quajta 'livadhi i deleve', sepse atje kishte vetëm dele, shkoja me ecje të shpejtë. Atje nisja vrapin, buzë një are të mbjellë me misër, prej nga herë-herë ngrihej me frushullimë befasisht ndonjë fazan. (Një mbrëmje, Ana më përgatiti fazan të pjekur.) Kufiri i poshtëm ishte një tjetër livadh, të cilin e quajta "livadhi i kuajve", sepse atje kishte dy kuaj shumë të bukur, një i bardhë, tjetri ngjyrëkafe.

Përshtëndetsha çdo mëngjes edhe me delet, edhe me kuajt. Më ndodhte të hasja një zotëri, i cili nxirrte shëtitje qenin e tij. Dhe, me pak përjashtime, të gjithë drejtuesit ose drejtueset e makinave, në të dyja drejtimet, më përshtëndesninin miqësisht. Pastaj pashmangshëm përfundoja në studio, me një dritare të madhe që shihte nga kopshti. Nga dritarja, se nga e gjenin rrugën dhe futeshin brenda nuse-pashke. Por mua nuk më shqetësonin, për ne shqiptarët nusja e pashkës sjell fat.

U shkëputa rrallë nga Vila. Një pasdite Aleksandra më ftoi dhe unë vajta bashkë me

të në shatonë e skulptorit dhe piktorit belg Yves Rhaye, vdekur para disa vitesh, ku ekspozoheshin veprat e tij. Atje u mblodhën plot njerëz që, pasi vizituan ekspozitën në mjediset e shatosë, u përfshinë në një diskutim rreth veprës së autorit. M'u krijua mundësia, gjithashtu, të shkoja dy herë në Bruksel. Me këtë rast njoha Sigrid Bousset, drejtoreshë e Passa Porta-s, dhe Ilke Froyen, me të cilat kisha komunikuar shpesh para se të mbërrija në Vilë.

Poeti Franck më shoqëroi për një ditë të tërë në Bruksel, ku kisha qenë dhjetë vjet të shkuar. Kësaj radhe, falë Franck-ut, krijova një ide më të qartë për Brukselin, nga i cili mbaja mend vetëm Sheshin e Madh. Madje, gjatë vajtjes sime të dytë atje, kur u organizua në një librari në Passa Porta një takim me mua, pas takimit vizitova një muze veprash arti, i shoqëruar nga Milica, një vajzë serbe tepër e sjellshme dhe e bukur, me banim prej kohësh në Bruksel.

Tani, në Sylt, ku ende nuk kanë nisur të ftohtat e mëdha, erërat e forta dhe shirat e shumta, gjithçka më duket trillim i fantazisë. Mirëpo ekziston një fakt që e hedh poshtë këtë: libri im i ri, që do të botohet së shpejti. Të cilin e përfundova atje, te 'Villa Hellebosch', në atë mjedis të magjishëm mikpritës."

Së fundi, kjo kronikë rezidencash nuk do të ishte e plotë pa disa hollësira rreth ishullit Sylt dhe qëndrimit tim atje.

Ishulli ndodhet në Detin e Veriut, si mësova, është një vend pushimi për miliarderët gjermanë. Ai lidhet me kontinentin përmes një dige hekurudhore. Udhëtimi me tren nga Hamburgu deri atje, një udhëtim mbresëlënës për mua, mori nja tri orë. Pas tri orësh mbërritëm në ishull, ku dikush më priti dhe më shoqëroi me makinë deri në rezidencë. Kjo ndodhej jo fort larg bregut të detit dhe më vendosën në një apartament, në katin e dytë.

Në Sylt, doemos, u gjenda në një mjedis krejt të ndryshëm nga ai prej të cilit sapo isha larguar. Një hapësirë dunash, me bimësi të rralla, një rrugë automobilistike që linte në një rën anë dunat, në anën tjetër në varg ca ngrehina njëkatëshe, njëra më e çuditshme se tjetra, mbi çatitë e të cilave syri të shihte diku statujën e një kaprolli, diku të një lope, diku nja tri-katër dele, diku ndonjë kafshë tjetër, e kështu me radhë. Në këtë peizazh të pabesueshëm, gati prej përrallash, nën një qiell vazhdimisht të vrenjtur, unë u përshtata dhe vazhdova me përpikëri programin tim ditor me ecje të shpejtë, apo vrap të lehtë në të dyja drejtimet e rrugës, njëri që të

çonte në port, dhe unë e përshkoja deri në njëfarë vendi, tjetri në anën e kundërt, ku ndalesha rregullisht pranë një grumbulli ndërtesash: atje gjendej një treg, ku bëja pazaret ushqimore.

Në rezidencën e Syltit, ndryshe nga çdo rezidencë tjetër pararendëse, nuk shërbehej asnjë vakt, gjithsecili gatuate vetë, përndryshe mund të frekuentoje ndonjë nga lokalet aty rrotull. Tepër të shtrenjtë për mua, u detyrova për herë të parë në jetën time të gatuaja vetë. Unë që, i mësuar keq nga e ndjera nëna ime dhe më pas e deri më sot nga Lili, për punë kuzhine kam qenë dhe mbetem një zero!... Apartamenti i bollshëm ishte i pajisur me një kuzhinë, ku nuk mungonte asgjë, që nga soba me korrent, frigoriferi, pjatat, tiganët, gotat e verës, lugët e pirunët etj. Dhe, pak më këndej “aksesorëve” të kuzhinës, një banak ku ulesha për të ngrënë. Është një histori më vete sesi dhe me çfarë u ushqeva unë gjatë atij muaji, por, sigurisht, nuk ia vlen të zgjatem.

E veçanta e qëndrimit tim në Sylt: përveç artikullit që riprodhova më sipër, nuk shkrova asgjë. Sapo kisha mbaruar te “Villa Hellebosch”, jashtë çdo parashikimi,

romanin “Bolero në vilën e pleqve” dhe tepër shpejt për të menduar diçka të re. Në të kaluarën më kishte ndodhur më se një herë që, gjatë kohës që shkruaja një roman, të më ngacmonte ideja e ndonjë libri të ri. Kësaj radhe, asnjë ngacmim. Unë nuk e dija, ende nuk e ndieja, se kisha mbërritur në një pikë kur më duhej të reflektoja, të bëja një lloj “bilanci”. Dhe të ndërgjegjësohesha se me romanin “Bolero në vilën e pleqve” mbyllej një fazë e krijimtarisë sime, për t’ia lënë vendin një faze të re. Këtë e kuptova pak më vonë, në Nju-Jork, ku iu futa shkrimit të librit “Iluzione në sirtar”, por siç thashë, për sa kohë qëndrova në Sylt, asnjë ngacmim për të, asnjë ide. Përkundrazi, u mora me diçka krejt tjetër.

Meqë shumë shpejt, me t’u kthyer në Shqipëri do të nisesha për në Nju-Jork dhe isha tapë topi në gjuhën angleze, kisha marrë me vete një tekst të rekomanduar për fillestarët, për mësimin autodidakt të një anglishteje elementare. Dhe një fjalor, që e gjeta në shtëpi, të cilin duket e kishte përdorur Elda dikur. Një nga dy autorët e këtij fjalori ishte Ilo Stefanllari, mik dhe ish-bashkëstudent imi në epokën e studimeve në Kinë. Në Sylt, pra, u mora me mësimin autodidakt të njohurive elementare të gjuhës angleze.

Gjatë atij muaji në mjediset e rezidencës, matanë godinës ku banoja unë, u organizuan disa veprimtari, ku njoha kalimthi shumë njerëz, shkrimtarë dhe artistë, për të cilët nuk më ka mbetur në kujtesë asgjë. Mbaj mend mirë vetëm një person. Kujtimi i tij lidhet me një nga fotografitë e mia më domethënëse, që më vonë e kam përdorur për kopertinën e librit “Iluzione në sirtar”. Ia mësova edhe emrin, por ia harrova shpejt dhe për këtë më vjen shumë keq.

Ai erdhi tek unë një paradite, me një aparat fotografik në dorë. Ishte shtatmesatar, rreth të tridhjetave, i zeshkët. Uzbek me origjinë, nëse nuk gaboj, prej vitesh jetonte e punonte në Gjermani dhe prej disa kohësh në rezidencë. Pasi mbaroi seancën e fotografive, gjatë së cilës komunikuam në gjuhën ruse, unë e ftova të pinim nga një gotë verë. Ndërkaq isha aftësuar disi në punët e kuzhinës dhe përgatita shpejt e shpejt diçka për të shoqëruar verën. Fotografinë në fjalë ai ma ka bërë tek pinim verë në banak dhe ma dhuroi para se të largohesha nga ishulli.

Ky episod nuk u mbyll me kaq. Pak kohë pas botimit të librit “Iluzione në sirtar”, unë mora prej tij një *e-mail*, në gjuhën ruse, por me shkronja latine. Ai njeri i mirë më falënderonte. Më shkruante se ndihej mjaft

i gëzuar që unë kisha zgjedhur fotografinë e tij për kopertinën e librit, të cilën e kishte ndeshur në internet. Të them të drejtën pas këtij *e-mail-i* të papritur unë u ndjeva i lehtësuar. E kisha përdorur fotografinë pa lejen e autorit. Pa shënuar as emrin e tij, për arsyen qesharake se nuk ia mbaja mend. Asnjë fotograf profesionist, dhe miku im ishte një profesionist, nuk mund ta pranonte këtë, dikush tjetër mund të më kishte hapur telashe. Por ai vetëm më falënderoi.

Pas disa kohësh, ai më dërgoi një tjetër *e-mail*, gjithnjë në gjuhën ruse me shkronja latine. Më thoshte se bashkë me një kolegun e tij gjerman dëshironin të vinin në Shqipëri. Dhe më pyeste nëse ishte e mundur t'i jepja një numër telefoni që të lidhej me mua sapo të mbërrinin. Ia dhashë plot kënaqësi edhe numrin e telefonit të shtëpisë, edhe të celularit. Por ata nuk erdhën. Dhe qysh atëherë nuk kam pasur më asnjë komunikim me të. Dëshiroj dhe uroj me gjithë shpirt të jetë mirë.

6.

Më 24 dhjetor të atij viti, një ditë para Krishtlindjeve, pas më se gjashtë vjetësh, ndërmora udhëtimin tim të dytë për në SHBA, kësaj radhe me një ndryshim thelbësor: në vend të një vize të thjeshtë për qëndrim të përkohshëm, isha i pajisur me të gjithë dokumentacionin e duhur të bashkimit familjar me tim bir, Dorianin. Lili ndodhej atje qysh nga fundi i nëntorit, kur ishim nisur pothuaj njëkohësisht, ajo për në Nju-Jork, unë për në Sylt.

Atëherë Dori sapo kishte hyrë në shtëpinë e re. Mua dhe Lilin na vendosi në dhomën e madhe të apartamentit, për vete mbajti të voglën. Bashkë me Eldën ishin kujdesur që ne të mos na mungonte asgjë. Veçanërisht mua. E kam fjalën për të më krijuar kushte sa më të mira pune. Danieli, bashkëshorti i Eldës, kishte mundur të siguronte një tryezë masive, me të ndara e sirtarë të shumtë, që më ra në sy me të shkelur për herë të parë

në atë dhomë. Atje Dori kishte instaluar një kompjuter, me të cilin kishte punuar për vite me radhë. Në vend të tij, për vete kishte blerë një laptop. Më vonë ai i dhuroi edhe Lilit një laptop të tipit “Samsung”. Kur ajo u pajis me mjete të tjera, laptopin zura ta përdorja unë, madje e kam në përdorim edhe sot e kësaj dite.

Befasia më e bukur në shtëpinë e re të Dorit: Irina, vajza ruse për të cilën ai më kishte folur në Vjenë. Tani ajo është bashkëshortja e tij, kanë edhe një djalë, në çastin që po shkruaj këto radhë, diçka më shumë se dy vjeç. Por këtu, dua të them dy fjalë, së pari për vajzën që do të bëhej gruaja e tim biri. Gjatë pothuaj shtatë vjetëve që jetuam bashkë, në të njëjtin apartament, as unë, as Lili, nuk mbajmë mend ta kemi dëgjuar të flasë me zë të lartë. Shumë rrallë, por ndodhte, Dori edhe e ngrinte zërin. Irina asnjëherë, absolutisht.

Kishte mbërritur në Nju-Jork për të ndjekur një kurs të gjuhës angleze por, si na e pohoi edhe vetë, e vendosur për të mos u kthyer më andej nga kishte ardhur: qyteti i largët i Ruisë, Çeliabinsk, pranë Uraleve. Nga leximet e mia për Luftën e Dytë Botërore, dija se Çeliabinsku ishte një qytet tepër i ftohtë në dimër, prej më se një

milion banorësh. Po nga këto lexime, kisha mësuar gjithashtu se, gjatë asaj periudhe të përgjakshme, ish-diktatori Stalin, kishte transferuar atje me qëllim që të mos binte në duart e nazistëve, pjesën më të madhe të industrisë ushtarake të vendit. Pra, edhe Irina, ashtu si fëmijët e mi, ashtu si qindra, mijëra të tjerë nga të katra anët e botës, kishte mbërritur në Nju-Jork në kërkim të ëndrrës amerikane. Dhe nuk u habita aspak kur na pohoi se kishte ardhur këtu për të mos u kthyer më andej nga kishte ardhur.

Do të doja të zgjatesha ca tek “Ëndrra Amerikane” (American Dream) sepse, si dihet, Amerika nuk është dhe aq “rozë”, nuk është, si thuhet shpesh ndër ne shqiptarët, “Ha-Merr-Ik”. Megjithatë, jam i bindur, nuk ka pasur e nuk ka një vend tjetër në botë më demokratik, më të hapur e më mikpritës sesa Amerika. Doemos, për të gjithë ata që e duan këtë vend, që zbatojnë ligjet e tij, që dëshirojnë ta realizojnë veten e të ecin përpara me djersën e ballit dhe punë të ndershme. E them këtë jo thjesht sepse, në çastin kur më është dhënë shtetësia amerikane, jam betuar solemnisht për besnikëri ndaj këtij vendi, që tashmë është bërë atdhe i parë për fëmijët e mi, dhe atdhe i dytë për mua. E them sepse kështu